



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË

VENDIM
Nr 142 Datë 22/12/2008

PER

Miratimin e fondit për prishjen e një seksioni në ish konviktin e ndërtimit

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Hapësinor **“Për miratimin e fondit për prishjen e një seksioni në ish konviktin e ndërtimit”**, bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008», Udhëzimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008», Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008», V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr. 9643 dt. 20.11.2006 « Për prokurim publik », i ndryshuar, neni 33, pika 5/a si dhe V.K.M. nr. 1 dt. 10.01.2007 « Për rregullat e prokurimit publik » kreu IV, pika 5/a, paragrafi i gjashtë, vendimi nr 46. dt. 24.11.08 i Keshillit të rregullimit të Territorit, Bashkia Korçe, si dhe mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë miratimin e fondit për prishjen e një seksioni në ish konviktin e ndërtimit.
2. Ky fond do të përballohet nga fondi i planifikuar i pagave në Buxhetin e Bashkisë 2008 me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00	01110	05	Art 6000000	-	400.000	Bashkia
Shtohet	00	06260	05	Art 6020000	+	400.000	NSHP

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe NSHP.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Raimonda Nase